

# Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës 2004

## Si të merrni pjesë?

**1** Aplikacionet duhet të dorëzohen para datës 10 gusht 2004:

Nëse jeni regjistruar për zgjedhjet e mëparshme të Kosovës, kërkonte fletëvotimin duke plotësuar dhe dërguar me postë aplikacionin tuaj\* bashkë me fotokopjen e dokumentit tuaj të identifikimit

Nëse nuk jeni regjistruar për zgjedhjet e mëparshme të Kosovës, regjistrohuni tani duke dërguar aplikacionin tuaj\*\* bashkë me fotokopjet e dokumenteve që dëshmojnë se jeni votues me zotësi juridike\*\*\*.

**2** Pasi të keni dërguar me postë aplikacionin tuaj, ju do të merrni një fletë njoftimi.

**3** Disa javë para zgjedhjeve të Kuvendit të Kosovës të caktuara për 23 tetor 2004, me postë do t'ju dërgohet fletëvotimi.

**4** Pasi të keni shënuar fletëvotimin, atë duhet ta ktheni me postë.

\* Nëse jeni regjistruar për zgjedhjet e mëparshme të Kosovës, atëherë aplikacioni do t'ju dërgohet me postë.

\*\* Aplikacionet mund të merren nga gazetatat kryesore, ose duke thirrur në telefonat +381-38-249-312,

+381-38-249-313, +381-38-249-314, +43-151-436-910 ose duke i nxjerrë ato nga [www.zgjedhjetekosoves.org/bmo](http://www.zgjedhjetekosoves.org/bmo).

\*\*\* Keni zotësi juridike për të votuar, nëse mund të paraqitni fotokopjet e dokumenteve që dëshmojnë se keni jetuar në Kosovë dhe se jeni larguar nga atje më 1 janar 1998 ose pas asaj date, dhe që më 23 tetor 2004 së paku do të jeni 18 vjeçar/e.